

Burimi: deklarata M.L, FDH-31837.

Sefer (Sefë) Elshani

(20.06.1934, shqiptar nga Gllobari/Globare, komuna e Gllogocit/Glogovac, bujk, gjashtë fëmijë)

Seferi u nis në xhami në Gllogoc/Glogovac, në mëngjesin e datës **8.05.1998**. Kishte në plan që rrugës të ndalej në **Komarani/Komorane** dhe të vizitonte të bijën Sadeten, e cila sapo kishte lindur një foshnje. Po atë ditë, familjarët kanë mësuar se Seferin e kanë plagosur rëndë në Komaran/Komorane, kur forcat serbe i kishin sulmuar me granata pozicionet e UÇK-së. Seferin e kishin çuar menjëherë në spitalin e Prishtinës/Priştina. Dy ditë më vonë, ai ndërroi jetë nga plagët e rënda. Familjarët e kanë varrosur Seferin në varrezat e fshatit Gllobar/Globare më 10.05.1998.

Burimet: deklarata V.E, FDH-5973; KMDLNJ, *Buletini*, num. 7, prill-qershor, 1998, 127, FDH-23816.

Besim (Daut) Halili

(25.04.1967, shqiptar nga Tërdeci/Trdevac, komuna e Gllogocit/Glogovac, student, dy fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Besimi ishte student i Fakultetit të Bujqësisë. Për shkak të situatës së vështirë ekonomike në Kosovë, ai në fillim të viteve të nëntëdhjeta i braktisi studimet dhe shkoi për të punuar në Zvicër, e më pas edhe në Francë. Atje i kaloi pesë vjet. Pas fillimit të konflikteve në Kosovë, u kthye në vend dhe aderoi menjëherë në UÇK. Ka qenë në Shqipëri për të kryer trajnime ushtarake. Ka rënë në betejë me forcat serbe, e cila u zhvillua më **9.05.1998** në **Llapushnik/Lapušnik**. U varros në varrezat e Tërdecit/Trdevac më 10.05.1998.

Burimet: deklarata E.H, FDH-25872; SHFDU-ÇK, *Feniksët...*3, 99-101, FDH-24476; KMDLNJ, *Buletini*, num. 7, prill-qershor 1998, 143, FDH-23816; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

Vladimir (Jovan) Spasić

(14.02.1936, serb nga Beogradi, një fëmijë, pensionist)

Vladimiri ka qenë nga Gjurakoci/Đurakovac [Istog/Istok]. Para pensionimit ka punuar në Ministrinë e Jashtme të RSF të Jugosllavisë. Jetonte me bashkëshorten Radmilën në Beograd. Vajzën e kishin në Amerikë. Në datën 10.05.1998, Vladimiri u kthye nga Kosova, ku me djalin e të vëllait ishte në vizitë të e ëma Magdalena, e cila jetonte në Gjurakoc/Đurakovac. Po atë ditë, ai iu lajmërua me telefon Radmiles, e cila ishte në vizitë te vajza në Amerikë. Ishte kjo hera e fundit që ata patën rastin të binin në kontakt. Radmila ka mësuar më vonë se Vladimiri, në mesditën e datës **19.05.1998**, e kishte vizituar një shqiptar, i cili e mbante një dyqan bizhuterish në Qendrën Sava. Menjëherë pas kësaj vizite, ai ishte nisur sërish për në Kosovë. Herën e fundit e shihnin të gjallë në rrugën Prishtinë/Priştina – Pejë/Peć, te **Komarani/Komorane**. Nga ajo ditë, Vladimirit i është humbur çdo gjurmë. Në listën e të zhdukurve të KNKK-së, rasti i tij është i evidentuar me numrin YUK-050035-01.

Burimet: deklarata R.S, FDH-28097; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817; Z. Stijović, *Kosmet...*, 120; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795.

Miroslav (Dragoljub) Šuljinić

(8.06.1969, serb nga Videja/Vidanje, komuna e Klinës/Klina, axhustator)

Miroslavi jetonte në bashkësi familjare me të atin Dragoljubin, të ëmën Ratken, të vëllain Jeremin dhe motrën Snežanen, në shtëpinë familjare në Videjë/Vidanje. Punonte në një fabrikë në Klinë/Klina. Kur filluan konfliktet në Kosovë, Miroslavi nisi nga puna në një zdrukthetari private në fshatin Dobri Do te Kurshumlja [Serbi]. Në datën **21.05.1998**, Miroslavi u nis me veturën e tipit *Tojota Korola* të ngjyrës blu në Dobri Do, për pagat e disa punëtorëve. Po atë ditë, nga ora 15:00, e mori rrugën e kthimit për në Videjë/Vidanje. Në postbllokun policor në **Komarani/Komorane**, në rrugën Prishtinë/Priştina – Pejë/Peć, policia e ka ndalur dhe i ka tërhequr vërejtjen se udhëtimi nuk ishte i sigurt më tutje, sepse pjesëtarët e UÇK-së e kishin